



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 23.01.2023

Nr. 343 Prot.

Drejtuar: Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore

Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë.

Lënda: Mbi plotësimet në Kodin Zgjedhor lidhur me votimin nga jashtë vendit

Të nderuar,

Sikurse mundet të jeni në dijeni Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr. 38 datë 09.12.2022 (V-38/22) në lidhje me votimin nga jashtë vendit ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së kërkuarit Shoqata "Diaspora për Shqipërinë e Lirë".
2. Konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligjor.
3. Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një viti.

Sikurse mundet të kuptohet edhe nga urdhërimi i Gjykatës Kushtetuese plotësimi i boshllëkut ligjor në lidhje me votimin nga jashtë, sa më shpejt të jetë e mundur, krijon kushtet objektive për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për miratimin e akteve përkatëse nënligjore si dhe përgatitjen e kushteve për realizimin e votimit nga jashtë për zgjedhjet e radhës për Kuvendin.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konfirmon gadishmërinë për të dhënë çdo kontribut që do të kërkohet nga Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore apo Kuvendi i Republikës së Shqipërisë lidhur me çështje të natyrës rregullatore dhe teknike sa i takon realizimit të votimit nga jashtë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

